

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Për: Shoqërine “**EN BI POWER**” sh.p.k, me adrese: Rruga e Kavajes, Kompleksi 100 Vitrinat, Kulla II, Kati 3, Tirane dhe me Nr. NIPT K47905860J.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë “E hapur- pune”**”

Numri i referencës së procedurës: **REF-85862-09-16-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i prokurimit është **“Rikonstruksion i kabinave murature te fiderave C15, C7, C14, C5, C6, 312, 311, Q1 dhe Q2 te N/stacionit Traktora”**, me fondin limit total **110,083,113 (njqind e dhjete milion e tetedhjetë e tre mijë e njqind e trembedhjetë)** leke pa TVSH dhe me afat realizimi 4 (kater) muaj nga data e dorezimit te sheshit nga mbikqyresi.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 38 date 24.09.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë Operatorët Ekonomik me vlerën përkatëse të ofruara:

- **OE: “ EN BI POWER” sh.p.k, me NIPT K47905860J** e cila ka paraqitur nje oferte ekonomike me vlere **103,602,081 (njqind e tre milion e gjashteqind e dy mijë e tetedhjetë e nje)** leke pa tvsh.
- **OE: “BE-IS” sh.p.k, me NIPT K71412003A** e cila ka paraqitur nje oferte ekonomike me vlere 104,530,486 (njqind e kater milion e peseqind e tridhjetë mijë e katerqind e tetedhjetë e gjashtë) leke pa tvsh.
- **OE: “ERGI” sh.p.k, me NIPT K02727229P** e cila ka paraqitur nje oferte ekonomike me vlere 104,611,867 (njqind e kater milion e gjashteqind e njembëdhjetë mijë e teteqind e gjashtedhjetë e shtatë) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE **“ERGI” sh.p.k** qe me shkresen Nr. 20344 Prot, date 01.11.2018, ka kerkuar terheqjen nga oferta pasi makinerite dhe stafi jane te angazhuara ne kontrata te tjera. KVO ka pranuar kerkesen dhe nuk ka bere vleresimin e ofertes se subjektit **“ERGI” sh.p.k.**
2. KVO ka vendosur te skualifikoje OE **“BE-IS” sh.p.k** pasi:

1.Ne DST, Shtojca 12, “Kriteret e Vecanta te Kualifikimit”, pika 2.3.1 per “Kapacitetin Teknik dhe Profesional, pika c, ku Operatori Ekonomik duheteparaqesedokumentacionin teknik (autorizim prodhuesi/distributori, Teste, katalog) te kerkuar per listen e materialeve. Nga kontrolli i dokumentacionit te paraqitur rezulton:

Per artikujt:

- **Cela te motorizuara**
- **Cele transformatori**
- **Cele linje**

**- Kablo XLPE**

I gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur nga OE me perjashtim të Autorizimit të Prodhuesit është ne gjuhe të huaj, duke qene ne kundershtim me kerkesat e DST ku gjuha e perdorur ne oferte duhet te jete gjuha shqipe.

2.Makinerite e deklaruar ne kete procedure prokurimi, rezultojne te njejtat me makinerite e angazhuara ne kontraten me objekt “Ndertimi Fiderit 20 KV C19 te Nenstacionit 110/20/6 KV Traktora Kabina te reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me Kabell ABC (Punetori)” te lidhur me Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane OSHEE sh.a.

3.Referuar ekstraktit QKB te OE rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitetet tregtar ne Uren Vajguore Berat pergjate vitit 2018, por nuk dorezon vertetim per taksat vendore prane kesaj njesie Administrative.

4.Referuar kontrates individuale te punes te punemarresit Ilmi KOLA (drejtues teknik i deklaruar per kete objekt), paga e tij bruto rezulton 50.000 leke ne muaj. Ndersa referuar listepageses se 12 muajve te fundit, paga e tij bruto rezulton ne 40.000 leke ne muaj.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “**EN BI POWER**” sh.p.k, me adrese: Rruga e kavajes, Kompleksi 100 Vitinat, Kulla II, Kati 3, Tirane dhe me Nr. NIPT K47905860J, me një vlerë të përgjithshme prej **103,602,081 (njqind e tre milion e gjashtëqind e dy mije e tetdhjete e nje)** lekë pa TVSH, pikët totale të mara 100 pike, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, (Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetëse, Njësia e Prokurimit) kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.11.2018